

WSI SH.P.K.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCES	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 18

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	29,770,009	4,139,137
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	206,816	146,742
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	387,603,030	472,878,724
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	4,978,996	7,356,197
Total aktive afatshkurtra		422,558,851	484,520,800
Aktivitet afatgjata			
Aktive financiare	8	340,620,084	223,058,200
Total aktive afatgjata		340,620,084	223,058,200
Total aktive		763,178,935	707,579,000
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	9	82,745,221	60,086,351
Detyrime tatimore	10	71,089	70,621
Të tjera detyrime	11	25,223,075	666,285
Total detyrime afatshkurtra		108,039,385	60,823,257
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	64,475,000	60,885,000
Total detyrime afatgjata		64,475,000	60,885,000
Totali i detyrimeve		172,514,385	121,708,257
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	13	3,200,000	3,200,000
Rezerva të tjera		582,670,743	591,077,720
Fitimi/(humbja) e ushtrimit		4,793,807	(8,406,977)
Total kapitali		590,664,550	585,870,743
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		763,178,935	707,579,000

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës Financiare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura/(shpenzime) të tjera të shfrytëzimit neto	14	269,059	(5,188,358)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(1,088,431)	(4,133,927)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
2) Të tjera shpenzime	15	(1,088,431)	(4,133,927)
Shpenzime të personelit	16	(3,095,095)	(1,568,087)
1) Paga dhe shpërblime		(2,836,559)	(1,403,425)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(258,536)	(164,662)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	17	(153)	-
(Shpenzime)/të ardhura financiare neto	18	8,727,428	2,483,395
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		401,494	2,483,395
2) Shpenzime të tjera financiare		8,325,934	-
Fitimi/(humbja) para tatimit		4,812,808	(8,406,977)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	(19,001)	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(19,001)	-
Fitimi/(humbja) e vitit		4,793,807	(8,406,977)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		4,793,807	(8,406,977)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

WSI SH.P.K*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitimi / (humbja) e ushtrimit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	3,200,000	591,077,720	(8,406,977)	585,870,743
Fitimi / (humbja) e ushtrimit			4,793,807	4,793,807
Lëvizjet përmes kapitalit		(8,406,977)	8,406,977	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	3,200,000	582,670,743	4,793,807	590,664,550

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan nga administratori i shoqërisë WSI sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 31 mars 2021 nga:

Bleda Sinani

Vanessa Sinani
Administrator



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi/(humbja) e ushtrimit	4,793,807	(8,406,977)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative	8,595,033	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	210,839,953	(3,579,997)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	2,491,338	1,380,838
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(183,210)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	226,555,921	(10,606,136)
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e shoqërive të kontrolluara	-	264,000
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	(117,561,884)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(117,561,884)	264,000
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	48,498,000	-
Pagesa e huave	(131,592,066)	(167,368,900)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(83,094,066)	(167,368,900)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	25,899,971	(177,711,036)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	4,139,137	181,850,173
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(269,099)	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 29,770,009	4,139,137

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria “WSI” Shpk është regjistruar pranë QKB në 01/11/2013. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe nga statuti i saj.

“WSI” Shpk është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Kapitali i shoqërisë “WSI” Shpk është 3,200,000 Leke, i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 3,200 Lekë secila,

“WSI” sh.p.k është një shoqëri shqiptare me ortakë:

- Shoqëria SIG Holding GmbH zotërues i 100 kuotave ose 100 % të kapitalit të shoqërisë;

Administrator i shoqërisë, duke filluar nga data 25.10.2013 është zj.Vanessa Sinani.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është investime nëpërmjet zotërimit të aksioneve të shoqërive të tjera. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund të kryejë dhe të realizojë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, është si rrjedhim apo ka të bëjë me objektivat e renditura më sipër që të arrihet objektiviteti i shoqërisë.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Pjetër Bogdani, pallati 39/1, Ap 4/4, Tiranë dhe është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L32301006L.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuar dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

(Vlerat janë në Lek)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.6. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/LEK	123.70	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proçes” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat kontabël (vazhdim)****3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje kompjuterike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 5% (2019:0%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktiviteti tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

*(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat kontabël (vazhdim)****3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	29,770,009	4,139,137
Llogari rrjedhëse	29,770,009	4,139,137
Mjete monetare në arkë	-	-
	<u>29,770,009</u>	<u>4,139,137</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	206,816	146,742
	<u>206,816</u>	<u>146,742</u>

*(Vlerat janë në Lek)***6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të arkëtueshme nga Sig Holding	84,958,531	11,886,949
Të arkëtueshme nga Albania Stone Factory	25,977,000	25,571,700
Të arkëtueshme nga Premium Finance Invest	-	187,118,241
Të arkëtueshme nga BLUE TDI	-	27,195,162
Të arkëtueshme nga Imperium Invest	75,766,250	25,571,700
Te arkëtueshem tregtare nga palët e lidhura	11,725,628	8,009,172
Të arkëtueshme të tjera	189,175,621	187,525,800
	<u>387,603,030</u>	<u>472,878,724</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatimi mbi fitimin	30,996	49,997
Të arkëtueshme ndaj REAS Shpk	4,948,000	7,306,200
	<u>4,978,996</u>	<u>7,356,197</u>

8. Aktive financiare

Aktivitetet financiare përfaqësojnë titujt e pronësisë në kompani të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Pjesëmarrje tek Adria Entertainment	229,483,200	219,483,200
Pjesëmarrje tek Albania Stone Factory	2,000,000	2,000,000
Pjesëmarrje tek BLUE TDI	101,636,884	-
Pjesëmarrje tek Imperium Finance Invest	3,500,000	875,000
Pjesëmarrje tek Infinity Investment	4,000,000	700,000
	<u>340,620,084</u>	<u>223,058,200</u>

*(Vlerat janë në Lek)***9. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të pagueshme ndaj Adria Entertainment	61,518,176	59,994,434
Të pagueshme ndaj Sig Holding	94,045	91,917
Të pagueshme ndaj Doo Power Invest	11,133,000	-
Të pagueshme ndaj Green Line Holding	10,000,000	-
	<u>82,745,221</u>	<u>60,086,351</u>

10. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	36,066	36,006
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	35,023	34,615
	<u>71,089</u>	<u>70,621</u>

11. Të tjera detyrime

Detyrimet të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime ndaj personelit	483,075	666,285
Te tjera detyrime	24,740,000	-
	<u>25,223,075</u>	<u>666,285</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të pagueshme ndaj Sig Holding	64,475,000	60,885,000
	<u>64,475,000</u>	<u>60,885,000</u>

(Vlerat janë në Lek)

13. Kapitali i nënshkruar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerë 3,200,000 Leke. Gjatë vitit 2020 nuk ka pasur ndryshime në strukturën e kapitalit themeltar të shoqërisë.

14. Të ardhura/(shpenzime) të tjera të shfrytëzimit neto

Të ardhura/(shpenzime) të tjera të shfrytëzimit neto më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Fitime nga këmbimet valutore	318,171	1,573,998
Humbje nga këmbimet valutore	(49,112)	(6,762,356)
	<u>269,059</u>	<u>(5,188,358)</u>

Rakordimi me deklaratimet mujore të TVSH-së dhe Tatimit mbi fitimin

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-ne	
Shitje total të deklaruara në FDP-në e TVSH-së	-
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	-
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	-
Te ardhurat nga interesat	1074551
Të ardhura të tjera financiare	45
Fitim nga këmbimet valutore	10,759,934
Total të ardhura të deklaruara në FDP-në e Tatim fitimit	<u>11,834,530</u>

15. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë të analizuar si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Transferime, udhëtime, dieta	793,897	3,926,927
Shpenzime të tjera	8,056	-
Shpenzime administrative dhe noteriale	22,043	-
Komisione bankare	212,935	193,000
Taksa vendore	51,500	14,000
	<u>1,088,431</u>	<u>4,133,927</u>

*(Vlerat janë në Lek)***16. Shpenzime te personelit**

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga	2,836,559	1,403,425
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	258,536	164,662
	<u>3,095,095</u>	<u>1,568,087</u>

17. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë të analizuara si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Gjoha dhe penalitete	153	-
	<u>153</u>	<u>-</u>

18. Shpenzime/të ardhura financiare neto

Shpenzime/të ardhura financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë të analizuara si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për interesa	(650,338)	(1,157,777)
Interesa debitore	1,074,551	3,641,172
Humbje nga këmbimet valutore	(2,115,829)	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	10,441,763	-
Shpenzime të tjera financiare	(22,764)	-
Të ardhura të tjera financiare	45	-
	<u>8,727,428</u>	<u>2,483,395</u>

*(Vlerat janë në Lek)***19. Tatimi mbi fitimin**

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Fitimi para tatimit	4,812,808	(8,406,977)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë):	47,263	3,926,927
Shërbime dhe konsulenca juridike të panjohura	17,043	-
Shpenzime të panjohura për faqet online	7,456	-
Shpenzime financiare të tjera të panjohura	22,764	-
Dieta të panjohura jashtë vendit	-	3,926,927
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	4,860,071	(4,480,050)
Humbje fiskale e mbartur	(4,480,050)	-
Fitimi fiskal i tatueshëm	380,021	-
Tatimi mbi fitimin	19,001	-
	<u>4,793,807</u>	<u>(8,406,977)</u>

20. Angazhime dhe pasiguri*Çeshtje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çeshtje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

21. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.